

20051011359

L I G J
PËR NGARKIMIN E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË ME HUA TE BANKA
NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM-BANKA BOTËRORE SIPAS
MARRËVESHJES PËR HUAN E PARË PROGRAMORE PËR POLITIKA
ZHVILLIMORE-PDPL 1

Neni 1

Republika e Maqedonisë ngarkohet te Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim - Banka Botërore me hua në shumë prej 24.400.000 euro, të destinuar për realizimin e huas së parë programore për politika zhvillimore – PDPL 1.

Neni 2

Kushtet dhe mënyra e shfrytëzimit të huas nga neni 1 i këtij ligji, përcaktohen me Marrëveshjen për huan e parë programore për politika zhvillimore – PDPL 1, që do të lidhet midis Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim - Banka Botërore.

Në emër të Republikës së Maqedonisë, Marrëveshjen për hua nga paragrafi 1 i këtij neni do ta nënshkruajë ministri i Financave ose personi i autorizuar nga ai.

Neni 3

Afati i kthimit të huas nga neni 1 i këtij ligji është 17 vjet, me grejs periudhë prej 5 vjetësh dhe shkallë të kamatës LIBOR prej + 0.75% në vit.

Huaja do të kthehet në 24 anuitete gjysmëviti prej të cilave duke filluar prej 15 prillit 2011 deri 15 prill 2022, do të paguhet 23 anuitete të barabarta gjysmëviti në shumë prej 1.015.000 euro dhe më 15 tetor 2022 do të kthehet anuiteti i fundit në shumë prej 1.055.000 euro.

Në grejs periudhën prej 5 vjetësh, që paraqet edhe periudhën e realizimit të projektit, do të paguhet vetëm kamata e huas.

Neni 4

Në datën ose menjëherë pas datës së hyrjes në fuqi të Marrëveshjes për hua nga neni 2, paragrafi 1 i këtij ligji, paguhet provizion i njëhershëm-shpenzim në shumë prej 1% nga shuma e huas. Shuma e provizionit të njëhershëm mund të jetë edhe më e vogël se 1% në bazë të aktvendimit të marrë paraprakisht të Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim-Banka Botërore.

Për shumën e mjeteve të patërhequra nga huaja paguhet provizion në lartësi prej 0,75% në vit të përcaktuar nga ana e Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim-Banka Botërore.

Provizioni nga paragrafi 2 i këtij neni paguhet në gjysmëvit edhe atë më 15 prill dhe më 15 tetor secilin vit.

Neni 5

Shfrytëzues i mjeteve të huas nga neni 1 i këtij ligji është Ministria e Financave në emër të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë.

Neni 6

Republika e Maqedonisë, huan nga neni 1 i këtij ligji do ta paguajë nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi me ditën e botimit në “Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.